



Human Rights Review Panel

Buletini informativ nr. 17 – 01 korrik - 31 tetor 2017

- Seanca e fundit e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut gjatë seancës, e martë 17 tetor 2017
- Takimi me shefen e Misionit të EULEX-it Kosovë
- Publikimi i lëndëve të Panelit nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut – Pjesa e jurisprudencave të juridiksioneve të tjera
- Dorëheqja e znj. Elka Ermenkova, anëtare e EULEX-it, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Dorëheqja e znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Publikimi i vendimeve
- Numri i lëndëve
- Statistikat e lëndëve
- Seanca e radhës së Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Seanca e fundit e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) ka mbajtur seancën e 35-të nga data 16 deri më 18 tetor 2017. Paneli ka lëshuar dhjetë (10) vendime të papranueshmërisë.

Paneli bën të ditur se parashtresat e plota të EULEX-it Kosovë nuk i janë zbuluar ankuesit në Vendimin e pranueshmërisë të marrë në lëndën nr. [2011-27 F. dhe të Tjerë](#) nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut më 13 qershor 2017. Ky mos zbulim i parashtresave të plotë është vendosur mbi bazën se: “publikimi i tyre mund të ndikojë negativisht në efektivitetin operacional të Misionit ose në sigurinë e personelit të Misionit”, i referohet par. D, (11) Koncepti i llogaridhënies EULEX-i Kosovë - Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.

Paneli ka konstatuar se lëndët nr. [2016-06 dhe 2017-04, Uka kundër EULEX-it](#), ishin të papranueshme, pasi ato kanë dalë jashtë juridiksionit të tij dhe gjithashtu për shkak se nuk e kanë përfillur afatin gjashtë mujor për parashtrimin e ankesës në Panel, të përcaktuar në nenin 25(3) të rregullores së punës së Panelit (RrP).

Paneli ka shpallur lëndën nr. [2016-07, Qela kundër EULEX-it](#) të papranueshëm, pasi ajo binte jashtë juridiksionit të Panelit, neni 29(d) dhe po ashtu për shkak se ishte parashtruar jashtë afatit

kohor gjashtëmuor, të përmendur më lartë dhe se gjithashtu ishte qartazi e pabazuar, neni 29(e), RrP.

Paneli ka konstatuar se lëndët nr. [2016-08, Hasani kundër EULEX-it](#); [2016-25, Krasniqi kundër EULEX-it](#); [2016-26, T.G. kundër EULEX-it](#); [2016-27 Islami kundër EULEX-it](#); [2016-33, Bytyçi kundër EULEX-it](#); [2016-36, Statovci kundër EULEX-it](#) dhe [2017-03 dhe Bobaj kundër EULEX-it](#) kanë dalë jashtë kompetencës së Panelit, pasi që Paneli nuk ka kompetencë të shqyrtojë procedurat gjyqësore të gjykatave në Kosovë.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut gjatë seancës së mbajtur, e martë 17 tetor 2017



Nga e majta në të djathtë: Magda Mierzevska; John J Ryan; Anna Bednarek; Guenael Mettraux dhe Elka Ermenkova.

Takimi me shefen e Misionit të EULEX-it Kosovë

Paneli ka mbajtur një takim me znj. Alexandra Papadopoulou, shefe e Misionit të EULEX-it gjatë seancës së fundit, e martë 17 tetor 2017. Janë diskutuar çështjet e interesit të përbashkët në mes të EULEX-it dhe Panelit në lidhje me fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Publikimi i lëndëve të Panelit nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut – Pjesa e jurisprudencave të juridiksioneve të tjera:

Vendimet e fundit të Panelit lidhur me zhdukjet me forcë në lëndën [D.V., E.V., G.T., Veselinovic., H.S. dhe I.R. kundër EULEX - nr. 2014-11 to 2014-17](#) dhe lëndën [Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it - nr. 2014-34](#) janë publikuar në Shënimet informative të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e Gjykatës, edicioni gusht-shtator 2017.

Faqja e internetit: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, jurisprudenca e Gjykatës, edicioni gusht-shtator 2017:

http://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=caselaw/analysis&c=#n1347528850996_pointer.

Publikimi nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut paraqitet për referencë si më poshtë:

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut/Groupe consultative sur les droits de l'homme

Zhdukjet me forcë në Kosovë/Disparations forcées au Kosovo

Lënda D.V., E.V., G.T., Veselinovic, H.S dhe I.R. kundër EULEX-it/Affaire D.V., E.V., G.T., Veselinovic, H.S et I.R. c. EULEX – nos./nos 2014-11 to/à 2014/17 Lënda Sadiku-Syla k. EULEX-it/Affaire Sadiku-Syla c. EULEX – no/no 2014-34 Vendimet mbi bazueshmëri/Décisions sur le fond 19.10.2016.

Bashkimi Evropian ka themeluar Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut më 29 tetor 2009 me mandatin për të shqyrtuar shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë) gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Nëse Paneli, i cili është organ i pavarur, përcakton se ka ndodhur ndonjë shkelje, gjetjet e tij mund të përfshijnë rekomandime jo-detyruese për veprime korigjuese nga shefi i misionit.

Në arritjen e gjetjeve të veta, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike (KEDCP).

Në vendimet dhe gjetjet e veta, Paneli vazhdimisht iu është adresuar praktikës gjyqësore të standardeve të Konventës të zhvilluara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. (Për informacion të mëtejshëm mbi punën e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut shih faqen e tij të internetit dhe raportin vjetor 2016).

Ky grup i lëndëve kishte të bënte me personat e vrarë dhe të zhdukur, të ashtuquajtur “zhdukje me forcë” që kanë ndodhur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë në pjesën e dytë të vitit 1999 dhe në fillim të vitit 2000. Ankuesit pretendonin se kishte hetime jo të duhura penale për të vërtetuar faktet dhe se ka pasur dështim të njëpasnjëshëm për të përcaktuar përgjegjësinë e kryerësve.

Paneli ka marrë parasysh standardet e zhvilluara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut sipas nenit 2 të Konventës për atë sa autoriteteve publike iu ishte ngarkuar obligim procedural për të vërtetuar faktet në lidhje me shkeljet e pretenduara të së drejtës për jetë. Paneli ka shqyrtuar fushën e këtyre obligimeve në kontekstin e mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Paneli ka vlerësuar se reagimi procedural që pritet prej misionit duhet të jetë në përputhje me rëndësinë e shkeljes dhe rëndësinë e pretenduar të të drejtave të mbrojtura, por gjithashtu se shkalla e obligimeve të misionit nuk mund të shkojë më tej se sa që e ka diktuar natyra e kufizuar e mandatit ekzekutiv të misionit.

Paneli ka konstatuar se përpjekjet hetimore të EULEX-it ishin të pamjaftueshme dhe se kjo kishte rezultuar në shkelje të të drejtave të ankuesve të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në lidhje me këtë dhe me nenin 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës.

Dorëheqja e znj. Elka Ermenkova, anëtare e EULEX-it, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Znj. Elka Ermenkova, gjykatëse penale ndërkombëtare në Gjykatën Supreme/Gjykata e Apelit, Divizioni Ekzekutiv, EULEX-i Kosovë ka paraqitur dorëheqjen e saj nga EULEX-i dhe nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, për të filluar detyrën e vëzhgueses ndërkombëtare në Operacionin monitorues të udhëhequr nga Komisioni Evropian, në Shqipëri. Operacioni monitorues mbështet rivlerësimin e gjykatësve shqiptarë përmes monitorimit dhe mbikëqyrjes së të gjithë procesit të gjykatësve dhe prokurorëve shqiptarë. Operacioni i Monitorimit përfshinë partnerët brenda kornizës së procesit të integritetit evropian dhe bashkëpunimit euroatlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian.

Magda Mierzevska, kryesuese e Panelit, shfrytëzon mundësinë të falënderoj znj. Ermenkova për punën e saj të shkëlqyer profesionale dhe për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në Panel. Ajo ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në punën dhe shqyrtimet e Panelit me aftësitë e saja të

mira ligjore dhe me aftësitë për të argumentuar qëndrimet e saja ligjore. Njohja e saj e plotë e Misionit, historikut dhe kontekstit të tij ligjor dhe institucional, ishte jashtëzakonisht e dobishme në procesin e vendimmarrjes lidhur me lëndët, të cilat janë parashtruar në Panel. Jam shumë e kënaqur që arritjet e saja profesionale tashmë janë njohur përmes një oferte të këtij posti prestigjioz ndërkombëtar në Operacionin ndërkombëtar që udhëhiqet nga Komisioni Evropian në Shqipëri.

Dorëheqja e Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore, ka dhënë dorëheqje nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut më 25 gusht 2017 për të filluar detyrën e këshilltares për bashkëpunim juridik në EUROJUST, një agjenci e Bashkimit Evropian (BE-së). Kjo agjenci merret me bashkëpunim gjyqësor në çështjet penale dhe se është themeluar për të përmirësuar trajtimin e krimit të rëndë ndërkufitar dhe të organizuar duke nxitur bashkërendimin hetimor dhe prokurorial midis agjencive të shteteve anëtare të BE-së. Selia e EUROJUST është në Hagë, Holandë.

Publikimi i vendimeve

Të gjitha vendimet e Panelit janë publikuar në faqen e internetit të Panelit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, në: www.hrrp.eu.

Numri i lëndëve

Aktualisht në Panel janë tridhjetë (30) ankesa në pritje.

Statistika e lëndëve

Paneli ka shqyrtuar njëqind e gjatëdhjetë e pesë (165) lëndë prej se ka filluar punën e tij në qershor të vitit 2010. Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë ka bërë shkelje të të drejtave në njëzet e pesë (25) lëndë. Më tej është gjetur se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në njëzet e pesë (25) lëndë të tjera, të cilat ishin konsideruar të pranueshme. Shtatë (7) lëndë janë parashtruar në Panel që prej 1 janarit 2017 dhe aktualisht në Panel janë tridhjetë (30) lëndë në pritje.



Seanca e radhës së Panelit

Seanca e radhës së Panelit është caktuar të mbahet nga data 4 deri me 6 dhjetor 2017.

Vizitoni faqen tonë të internetit: www.hrrp.eu



SI TË PARASHTROHET ANKESA NË PSHDNJ

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga Misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk i shqyrton procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet në letër, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:



Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 28 2207

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës

elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Nëse ankesa parashtrohet përmes postës elektronike, atëherë ankesa origjinale e nënshkruar duhet të dorëzohet brenda katër javëve nga data e dërgimit të postës elektronike.

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter. Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit. Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.